

## MENDIM PAKICE

Unë, komisioneri Olsi Komici, në cilësinë e relatorit të trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit të datës 11.6.2021, të marrë nga shumica e trupit gjykues, nëpërmjet të cilit është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në vijim do të shpjegoj qëndrimin tim të arsyetuar kundër konkluzioneve dhe vendimit të shumicës së trupit gjykues, pa përsëritur argumentet e dhëna nga vetë subjekti dhe shumica e trupit gjykues, për të cilat kam mbajtur të njëjtin qëndrim. Kundërshtitë e mia në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues kanë të bëjnë me të tria kriteret e vlerësimit, duke i renditur si më poshtë:

### I. Vlerësimi i pasurisë

**1. Apartament me sipërfaqje totale 80 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, volumi \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Tiranë. Çmimi i blerjes së apartamentit 80,000 euro, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.8.2016. Pjesa takuese 50%.**

#### Burimi i krijimit:

- 1) të ardhura nga kredia e marrë te “Banka Credins” në shumën 7,000,000 lekë e konvertuar në 50,000 euro sipas kontratës së kredisë datë 17. 6.2016;
- 2) të ardhura nga huaja e marrë në shumën 28,000 euro sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.1.2017;
- 3) të ardhura nga paga personale dhe e bashkëshortit për vitin 2016 në shumën 2,000 euro. (Të ardhurat në total nga kredia + huaja + të ardhurat nga paga personale = me vlerën e apartamentit sipas kontratës së shitjes 80,000 euro).

Në lidhje me këtë pasuri, shumica e trupit gjykues ka arritur në konkluzionin se:

*“85. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën Vetting, për apartamentin e banimit, duke mos deklaruar vlerën e saktë të huas së marrë nga prindërit e saj lidhur me vlerën si burim krijimi, e vendos atë në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*

*86. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së (i) hua nga prindërit në vlerën 36.000 euro, (ii) të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kësaj pasurie.*

*87. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.”*

Në lidhje me këtë konkluzion të shumicës së trupit gjykues, nuk jam dakord, duke parashtruar argumentet e mia kundër si më poshtë:

1. Në lidhje me konkluzionin në pikën 85 të vendimit se kemi të bëjmë me deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të huas së marrë nga prindërit, nuk jam dakord me konkluzionin e deklaramit të pamjaftueshëm. Subjekti i rivlerësimit, si në deklaramtën “Vetting”, në DIPP e vitit 2016, ashtu edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit, ka argumentuar se shuma prej 28,000 euro e deklaramuar si hua është pjesa e mbetur e huas. Gjithashtu, subjekti ka deklaramuar ekstremite të sakta të kontratës së huas së datës 4.1.2017 e cila rezulton të jetë e depozituar në ILDKPKI, si pjesë e dokumentacionit që justifikon dhe shoqëron deklaramtën “Vetting”, në të cilën pasqyrohet qartë se shuma e huas është 36,000 euro, por si vetë kontrata, dokumentet bankare dhe shpjegimet e subjektit vërtetojnë se po brenda vitit 2016 është shlyer pjesa prej 8,000 euro e huas, duke mbetur akoma e pashlyer diferenca prej 28,000 euro, shumë kjo e deklaramuar si vlerë huaje në deklaramtën “Vetting” dhe në DIPP-në e vitit 2016.

Nga verifikimi i deklaramtës “Vetting” dhe i DIPP-së të vitit 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit tek të dhënat konfidenciale, ka deklaramuar me saktësi marrëdhënien e huas me prindërit, shumë e huas prej 36,000 euro, si edhe shlyerjen e një pjese prej 8,000 euro dhe burimin financiar që është përdorur për këtë shlyerje.

Sa më sipër, arrij në konkluzionin se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së huas së përdorur për blerjen e apartamentit, e cila fillimisht duhej të ishte deklaramuar në vlerën e përcaktuar në kontratë prej 36,000 euro dhe në vazhdim të jepeshin shpjegime në lidhje me vlerën e mbetur të saj prej 28,000 euro, por kjo pasaktësi, marrë shkas nga deklaramimet e subjektit në deklaramtën “Vetting” dhe në DIPP-në e vitit 2016, tek të dhënat konfidenciale ku përcaktohet saktë vlera fillestare e huas dhe shuma e kthyer, gjithashtu bazuar edhe në dokumentacionin shoqëruar, siç është kontrata e huas, e cila përcakton qartë si shumë fillestare të huas, ashtu edhe pjesën e mbetur të saj, rezulton të jetë me një peshë minimale dhe, si e tillë, nuk e vendos subjektin në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe gremës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2. Në lidhje me konkluzionin në pikën 86 të vendimit<sup>1</sup>, nuk jam dakord me konkluzion e shumicës së trupit gjykues, duke dhënë argumentet si më poshtë:
- a) prindërit e subjektit të rivlerësimit, si më vete, ashtu edhe nën statusin e personave të tjerë të lidhur me subjektin, nuk kanë qenë subjekte deklaramues, e për rrjedhojë nuk kanë pasur detyrimin ligjor të deklaramojnë shumë prej 56,000 USD ndër vite apo dhe pjesën e mbetur të saj në deklaramtën “Vetting”;
  - b) Shuma prej 56,000 USD është e padiskutueshme si burim i dhënies së huas nën kontekstin e ekzistencës dhe vërtetësisë së saj për sa kohë provohet nga dokumentet bankare: i) kontratë depozite në Bankën Amerikane të Shqipërisë e shumë 22,024.15 USD, krijuar në datën 22.10.2003 në emër të L.D. me gjendje 22,036.70 euro në datën 30.1.2004; ii) Kontratë depozite në Bankën Amerikane të Shqipërisë e shumë 34,000 USD krijuar në datën 18.9.2003 në emër të L.D. me gjendje 34,024.15 euro në datë 30.1.2004;
  - c) aktiviteti tregtar i prindërve të subjektit të rivlerësimit, shuma e përfutuar nga ky aktivitet si dhe burimi i ligjshëm i kësaj shume, vërtetohet si me prova direkte ashtu edhe indirekte, bindëse, si:

---

<sup>1</sup> “Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së (i) hua nga prindërit në vlerën 36.000 euro, (ii) të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo pasjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kësaj pasurie.”

c.1. deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.12.2020, me deklarues N.T. dhe M.K., të cilët deklarojnë se: “ *Ne deklaruesit në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklarojmë me përgjegjësi ligjore se nga muaji tetor i vitit 1993 deri në muajin gusht të vitit 2001, shtetasi L.D., i dtl. 3.5.1957, së bashku me bashkëshorten e tij N.D., e dtl. 27.11.1960, kanë punuar së bashku me ne, në tregun industrial me pakicë dhe shumicë në Fier dhe kanë paguar rregullisht taksat e Bashkisë Fier për aktivitetin që kanë kryer*”.

Në kushtet kur tregu industrial i qytetit të Fierit nuk ekziston më e për pasojë në të nuk ushtrohet më aktivitet tregtar, kjo dëshmi e personave që kanë ushtruar aktivitet tregtar me prindërit e subjektit në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, është bindëse e për rrjedhojë merr një vlerë të pakontestueshme.

c.2. deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 24.5.2021 ku deklaruesi M.M.D., ka deklaruar si vijon: “ *Unë deklaruesi, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklaroj me përgjegjësi ligjore se kam qenë inspektor taksash pranë Bashkisë Fier, nga viti 1991 – 2001, me shkëputje në vitin 1997. Me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, deklaroj se nga muaji tetor i vitit 1993 deri në muajin gusht të vitit 2001, shtetasi L.D., i dtl. 3.5.1957, së bashku me bashkëshorten e tij, N.D., e dtl 27.11.1960, kanë punuar së bashku me ne në tregun industrial me pakicë dhe shumicë në Fier dhe kanë paguar rregullisht taksat e Bashkisë Fier për aktivitetin që kanë kryer*”.

Për të provuar faktin që shtetasi M.M.D., i cili konfirmon si ushtrimin e aktivitetit tregtar në tregun industrial të qytetit të Fierit, ashtu edhe pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Fier, për vitet 1993 -2001, nga dy prindërit e subjektit, ka qenë i punësuar pranë kësaj Bashkie, është depozituar si provë edhe shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2021 e Bashkisë Fier, Drejtoria e Burimeve, Shërbimeve Njerëzore dhe Diasporës dhe Migracionit, nga ku rezulton se: “*Në bazë të të dhënave mbi bazën e vlerësueshme, mbi të cilat janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore, vërtetojmë se z. M.M.D. ka qenë punonjës i Bashkisë në pozicionin inspektor tregu i lirë, për periudhat 30 prill 1992 deri në 18 shkurt 1997 dhe periudhën 16 korrik 2001 deri në 30 prill 2002*”. Bashkëlidhur edhe vërtetimi për bazën e vlerësueshme për periudhën 30 prill 1992 – 18 shkurt 1997, si dhe për periudhën 16 korrik 2001 deri në 30 prill 2002.

Pra, rezulton se ky shtetas, ka qenë i punësuar në Bashkinë Fier me detyrë inspektor taksash, përgjatë periudhës kur të dy prindërit kanë ushtruar aktivitetin tregtar në këtë qytet dhe ka konfirmuar me anën e kësaj deklarate si kohëzgjatjen e aktivitetit tregtar të ushtruar nga prindërit e subjektit, ashtu edhe pagimin rregullisht të taksave të bashkisë në lidhje me aktivitetin që kryenin.

Ky deklaram, i bërë nën përgjegjësi ligjore nga personi i ngarkuar me ligj dhe nga organi ligjzbatues kompetent që është Bashkia Fier, për vjeljen e taksave nga tregtarët ambulantë në tregun industrial në qytetin e Fierit, që vërteton kohën e ushtrimit të aktivitetit tregtar të prindërve të subjektit si edhe pagesën e taksave, përbën një dëshmi/provë me vlerë të plotë dhe të pakontestueshme në lidhje me procesin e rivlerësimit.

c.3. Periudha kohore e shkurtër ndërmjet depozitimit nga babai i subjektit, të shumës prej 56,000 USD në bankë në fund të vitit 2003 dhe përfundimit të aktivitetit tregtar në vitin 2001, krijon bindjen se kjo shumë ka si burim pikërisht ushtrimin e aktivitetit tregtar.

c.4. Referuar legjislacionit të kohës, ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë. Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: *“Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguajnë tatim vjetor me kuotë fikse”* sipas veprimtarisë që kanë ushtruar. Në nenin 5 të këtij ligji parashikohet se: *“Tatimi vjetor sipas neneve 3 dhe 4 llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të komunave, bashkive e rretheve brenda muajit janar, për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi, dhe verifikime të bëra nga punonjësit e organeve tatimore”*.

Ligji nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” përcakton si kategori tatimpaguesish edhe shitësit ambulantë të cilët paguajnë kuotë fikse<sup>2</sup>. Po ky ligj sanksionon<sup>3</sup> përgjegjësinë e tyre për regjistrim.

Fakti i ushtrimit të aktivitetit tregtar nga prindërit e subjektit dhe mungesa e dokumentacionit përkatës që vërteton ushtrimin e këtij aktiviteti dhe pagesën e taksave, rezulton nga korrespondenca e kryer me Bashkinë Fier, konkretisht me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 11.12.2020 të Bashkisë Fier, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, drejtuar z. L.D., nga e cila rezulton se: *“Bashkia Fier ka në funksion sistemin TAIS (sistemi i administrimit të informacionit të taksave dhe tarifave vendore), në të cilin regjistrohen subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi në Bashkinë Fier është në funksion nga viti 2016 dhe përfshin të dhëna nga ky vit. Ju sqarojmë se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka arkivë dhe nuk ka një regjistër ku të dokumentohen pagesat e taksave në vitet tetor 1993 -gusht 2001, ku ju kërkon informacion dhe ku ju keni ushtruar aktivitetin tuaj si tregtar ambulant në tregun industrial me shumicë dhe pakicë së bashku me bashkëshorten tuaj. Përsa i përket vitit kur taksat kanë filluar të paguhesh në Bashkinë Fier, ju sqarojmë se me miratimin e ligjit Nr.9632, viti 2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar ka filluar punën Drejtoria e Taksave Vendore. Tregtarët ambulantë në vitet ku ju kërkon informacion, nuk kanë pasur detyrimin të regjistrohen në Bashki, por kanë paguar biletë ditore për zënien e vendit ku ushtrojnë aktivitet”, si dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2021 të Bashkisë Fier, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, ku pasqyrohet fakti se: *“Ju sqarojmë se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, nuk ka arkivë dhe nuk ka regjistër ku të dokumentohen pagesat e taksave në vitet 1993-2001, ku ju kërkon informacion për aktivitetin ambulant të shtetasve L.Q.D. dhe N.R.D. Tregtarët ambulantë në vitet ku kërkohet informacion nuk kanë patur detyrim të regjistrohen në Bashki, por kanë paguar biletë ditore për vendin ku ushtrohet aktivitet”*.*

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2021, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier sqaron se: *“Nuk rezultojnë të dhëna lidhur me regjistrimin si aktivitet tregtar të shtetasve të cituar, (L. dhe N.D.) për periudhën 1993-2001. Ambulantët janë pjesë e veprimtarisë së Drejtorive Rajonale Tatimore që nga viti 2003. Për periudhat 1993-2001, kjo kategori biznesi është administruar nga pushteti vendor”*.

---

<sup>2</sup> Kreu II, neni 3, Pika E1.

<sup>3</sup> Neni 9, pika dh): Përbëjnë kundërvajtje administrative këto shkelje: *“.....pika dh) mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit nga tatimpaguesit ambulantë, kur ajo kërkohet nga organi tatimor”*.

Nga sa më lart, duke qenë se vërtetohen në mënyrë bindëse faktet se:

- i. shtetasit L. dhe N.D., prindërit e subjektit të rivlerësimit, kanë ushtruar aktivitet si tregtarë ambulantë në tregun industrial të qytetit të Fierit për periudhën 1993-2001;
- ii. drejtorja e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Fier, nuk ka arkivë dhe nuk ka regjistër ku të jenë dokumentuar pagesat e taksave në vitet 1993-2001;
- iii. tregtarët ambulantë, për periudhën kohore kur është kërkuar informacion, 1993-2001, nuk kanë pasur detyrim të regjistrohen në Bashki, por kanë paguar biletë ditore për vendin ku ushtrohet aktivitet;
- iv. ambulantët janë pjesë e veprimtarisë së Drejtorive Rajonale Tatimore që nga viti 2003. Për periudhat 1993-2001, kjo kategori biznesi është administruar nga pushteti vendor;

arrij në konkluzionin se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka provuar në mënyrë bindëse faktin e ushtrimit të aktivitetit tregtar nga personat e tjerë të lidhur me të, prindërit e saj, L. dhe N.D.;
- ii. institucioni shtetëror i ngarkuar me ligj për mbledhjen e taksave vendore, Bashkia Fier, të paktën deri në vitin 2001 kur prindërit e subjektit kanë ushtruar aktivitetin tregtar, nuk ka arkivë dhe regjistër ku të jenë dokumentuar pagesat e taksave në vitet 1993-2001 dhe kjo jo për faj të subjektit të rivlerësimit apo prindërve të saj;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë në mënyrë shtrënguese të gjithë hapat e duhur ligjorë pranë institucioneve të ngarkuara me ligj (për evidentimin e subjekteve tregtare, mbledhjen e taksave dhe tatimeve, pasqyrimin në regjistra të posaçëm të këtyre subjekteve dhe pagesave të kryera prej tyre), për marrjen e informacionit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit tregtar nga prindërit e saj dhe pagesën e taksave dhe, marrë shkas nga përgjigjet e këtyre dy institucioneve, Bashkia Fier dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë (shumës prej 56,000 USD depozituar në bankë në dhjetor të vitit 2003), çka e kategorizon subjektin e rivlerësimit në kushtet e aplikimit të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016<sup>4</sup>, e për rrjedhojë, shuma prej 56,000 USD është një burim i ligjshëm financiar, që justifikon në mënyrë bindëse një pjesë të shumës prej 36,000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit prej personave të tjerë të lidhur, prindërve të saj L. dhe N.D.

Në lidhje me këtë burim, gjej me vend edhe analogjinë e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me përfundimet e arritura nga trupi gjykues i KPK-së në dhënien e vendimit nr. 242, datë 28.2.2020<sup>5</sup>, i cili ka marrë formë të prerë.

---

<sup>4</sup> “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive, për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri, ose nuk mund merret në rrugë tjetër...”.

<sup>5</sup> “1.112. Gjithsesi në lidhje me faktet dhe provat rrethore, të administruara gjatë hetimit për këto dy të ardhura, Komisioni çmon se ato gjithashtu duhet t’i nënshtrohet vlerësimit, duke patur parasysh: i) periudhën e gjatë dhe të largët të burimit të përfitimit të këtyre të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur; ii) faktin që subjekti i rivlerësimit ka qenë minore dhe më tej student gjatë kohës së fitimit të pjesës më të madhe të këtyre të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur; iii) faktin që subjekti ka depozituar disa prova rrethore, të cilat provojnë fluksin e parasë në familjen e tij para se të ishte subjekt rivlerësi/gjyqtar. 1.115. Në analizë të këtyre provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, mbi mënyrën e fitimit të të ardhurave nga trashëgimia dhe aktiviteti privat, trupi gjykues çmon se niveli i provueshmërisë për burimin e

ç) në lidhje me burimin tjetër të krijimit të shumës së dhënë hua prej 36,000 euro që janë krijuar nga shitja e apartamenteve në qytetin e Fierit dhe në Tiranë, që në total përbëjnë 2,500,000 lekë, arrij në përfundimin se provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit dhe shpjegimet e dhëna prej saj, krijojnë bindjen se ky burim përveçse rezulton të jetë i ligjshëm, gjithashtu edhe është përdorur për plotësimin e shumës prej 36,000 euro, duke argumentuar si më poshtë:

ç/1. me kontratën e shitblerjes datë 15.3.2001, prindërit e subjektit të rivlerësimit shesin një apartament në qytetin e Fierit për çmimin 1,500,000 lekë dhe në datën 18.1.2002, blejnë një apartament në qytetin e Tiranës për çmimin 1,000,000 lekë. Këto transaksione janë kryer përpara depozitimit të shumës prej 56,000 USD në institucionet bankare nga babai i subjektit në muajin dhjetor të vitit 2003.

ç/2. me kontratën e shitblerjes datë 15.7.2005, prindërit e subjektit kanë shitur apartamentin e blerë në vitin 2002, në Tiranë për çmimin 2,000,000 lekë. Me kryerjen e këtij transaksioni, prindërit e subjektit kanë pasur gjendje shumën prej 56,000 USD, (shumë kjo më se e mjaftueshme për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës më 28.3.2006 për shumën 19,800 euro) të tërhequra nga institucionet bankare në muajin janar të vitit 2004 dhe 2,000,000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit në Tiranë në vitin 2005.

ç/3. Të ardhurat nga shitja e apartamenteve në Fier dhe Tiranë, janë përmendur si burim krijimi për shumën e dhënë hua prej 36,000 euro, edhe në kontratën e huas datë 4.1.2017, kontratë kjo e hartuar përpara plotësimit dhe depozitimit të deklaratës “Vetting” nga subjekti.

Në lidhje me këto të ardhura, duke qenë se për to janë paguar detyrimet përkatëse tatimore e për rrjedhojë i bëjnë ato burime të ligjshme financiare, si dhe nisur nga fakti se ato janë deklaruar si burim në një dokument ligjor sikurse është kontrata e huas e datës 4.1.2017, e hartuar përpara dhe e pasqyruar në deklaratën “Vetting”, krijohet bindja e bazuar në fakte dhe prova se ato kanë shërbyer si burim krijimi të shumës prej 36,000 euro dhënë hua subjektit të rivlerësimit nga prindërit e saj në vitin 2016, konkretizuar me kontratën e huas datë 4.1.2017. Ky konkluzion bëhet akoma edhe më bindës për arsye se shuma prej 56,000 USD e tërhequr nga prindërit e subjektit nga institucionet bankare në muajin janar 2004, është më se e mjaftueshme për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës më 28.3.2006 për shumën 19,800 euro dhe për më tepër që, nga ana e prindërve të subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të jetë kryer ndonjë investim tjetër madhor gjatë gjithë kësaj periudhe, që do të bënte të mundur

---

*krijimit të këtyre të ardhurave, si dhe të ardhurat nga trashëgimia dhe aktivitetet private, janë të tilla që krijojnë bindjen për krijimin tyre nga personat e lidhur, duke patur parasysh faktin që personat e tjerë të lidhur, ...nuk kanë qenë subjekte të deklaratimit të pasurive, por edhe faktin se subjekti gjatë kësaj kohe ka qenë nxënës apo student. 1.117. Në këto kushte Komisioni vlerëson se personat e tjerë të lidhur, gjenden për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 2, të nenit 32 të ligjit nr.84/2016, ( cituar përmbajtja e ligjit)...për shkak se: i) faktin që në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave, personat e tjerë të lidhur, prindërit e subjektit nuk e gëzonin statusin e personave të tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit në kuptim të ligjit nr.84/2016 dhe nuk kishin ndonjë detyrim ligjor të tregoheshin të kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tyre në atë kohë, përveçse për atë sa ata e kanë çmuar të nevojshme sipas kujdesit të çdo qytetari normal; ii) koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura e bën të vështirë edhe vet ruajtjen e dokumentacionit, që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr për sipër të ruajtje apo të arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohë, madje as nga vet institucionet shtetërore”.*

ngritjen e dyshimeve për pamundësi financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit, si dhe për dhënien e huas prej 36,000 euro subjektit.

d) Argumentet e mësipërme rrëzojnë edhe konkluzionin tjetër të shumicës së trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit dështoi të bindte trupin gjykues se kjo hua e kishte burimin pikërisht nga të ardhurat që ndodheshin në bankë rreth 12 vite më parë, e që ishin tërhequr nga prindërit, për më tepër që prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë subjekte deklaruese ndër vite.

**Në përfundim, në lidhje me apartamentin e banimit, me sip. 80 m<sup>2</sup> dhe 9.7 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët, blerë për çmimin 80,000 euro, kundërshtoj konkluzionin e arritur nga shumica e trupit gjykues se: “ 87/122. subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë Vetting lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.”**, për arsye se, marrë për bazë, shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti dhe institucionet e tjera, si dhe argumentet e pasqyruara më sipër, krijohet bindja e bazuar në prova dhe në ligj se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare në lidhje me dy burimet e para të pagesës së çmimit të blerjes së apartamentit, konkretisht: a) kredia prej 7,000,000 lekë dhe huaja prej 36,000 euro dhe rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme financiare vetëm për burimin e tretë, pagesa e këstit prej 2,000 euro me burim nga të ardhurat nga pagat të subjektit dhe bashkëshortit të saj për vitin 2016.

Gjithashtu nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2012-2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë financiare negative prej -1,022,161 lekë, shumë kjo të cilën Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit e vlerëson në vlerë minimale, duke mos prodhuar pasoja të tilla, që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>231 917</b>	<b>1 116 068</b>	<b>1 680 783</b>	<b>1 954 351</b>	<b>1 960 176</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	194 840	807 290	843 326	851 085	1 053 969
Të ardhura nga paga e b/shortit	-	-	604 702	617 403	609 523
Të ardhura nga paga e babait	18 418	236 714	183 699	-	-
Të ardhura nga paga e nënës	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e motrës	18 659	72 064	-	30 870	118 461
Të ardhura nga pensioni i babait	-	-	49 056	179 693	178 223
Të ardhura nga shitja e mjetit	-	-	-	275 300	-
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>336 000</b>	<b>11 963 680</b>
Kredi bankare Credins Bank 7,000,000 lekë					7 000 000
Hua L. D 36,000 Euro					4 963 680
Hua L. D 336,000 lekë				336 000	
<b>Shpenzime</b>	<b>151 341</b>	<b>571 034</b>	<b>1 404 422</b>	<b>1 936 013</b>	<b>3 505 683</b>
Shpenzime jetike	141 024	564 096	1 228 322	1 345 656	1 410 552
Shpenzime mobilimi	-	-	-	-	150 000
Shpenzime udhëtimi	-	-	-	-	67 635
Blerje TV	-	-	-	90 000	-
Këst kredie Credins (principal+interesa+komisione)					376 387
Këst kredie (principal+ intrerresa + komisione) A A _500,000_18.01.2012			152 100	104 357	307 270
Këst kredie (principal+ intrerresa + komisione) L. D _100,000 _08.02.2010	10 317	6 938			
Kthim i huasë në shumën 8,000 Euro					1 093 840
Kthim i huasë në shumën 336,000				336 000	
Shpenzime udhëtime pune	-	-	24 000	60 000	100 000
<b>Pasuri</b>	<b>346</b>	<b>820</b>	<b>61 127</b>	<b>617 182</b>	<b>11 177 490</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	346	820	61 127	5 882	277 490
Tokë arë 10,000 m2 Shkodër, b/sh 1/4					
Autoveturë Daimler Chrysler, viti 2002				336 000	
Autoveturë Daimler Chrysler, viti 2003				275 300	
Apartament 80 m2, Tiranë					10 900 000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>80 230</b>	<b>544 214</b>	<b>215 234</b>	<b>-262 844</b>	<b>-759 317</b>

Duke marrë në konsideratë faktet, provat, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe të gjithë argumentet e mësipërme, kundërshtoj konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se: “127. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart në konsideratë edhe të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, subjekti i rivlerësimit znj. Luveda Dardha nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.”, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë.

## II. Kontrolli i figurës

Në lidhje me konkluzionet e shumicës së trupit gjykues, mbi kriterin e figurës<sup>6</sup>, paraqes mendimin tim kundër, duke argumentuar si më poshtë:

---

<sup>6</sup> “141. Trupi gjykues çmon se:

- *Vepra penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 381/1 i Kodit Penal, parashikon një masë dënimi me burgim nga 5 deri në 10 vjet dhe nga Prokuroria është kërkuar 7 vjet burgim, duke pasur parasysh faktin se i pandehuri ka transportuar një sasi lëndë narkotike prej 60 kg, ndërkohë, Gjykata, në përfundim, e ka vënë të pandehurin në periudhë prove me kusht të mos kryejë vepër tjetër penale.*

- *Aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit në rastin konkret, është zbatuar nga gjykata pa marrë parasysh kriteret specifike që parashikon legjislacioni në këto raste.*

- *Rrethanat për të cilat kjo dispozitë parashikon mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë të të dënuarit janë:*

*Rrezikshmëria e pakët e personit – kjo rrethanë, në mënyrë kategorike, nuk rezulton në rastin konkret. Nuk mund të quhet person me rrezikshmëri të pakët kur ky shtetas ka organizuar gjithçka që nga marrja e automjetit që i përkiste një shtetasi tjetër, paketimin e lëndës narkotike, transportimin e saj me këtë automjet, fshehjen e saj në një vend në pyll që të mos dukej dhe nuk mund të barazohet rrezikshmëria e këtij të pandehuri me rrezikshmërinë e një përdoruesi lëndësh narkotike, të cilit i është gjetur një sasi disa gramë lëndësh narkotike dhe që megjithatë gjykata ka pasur raste dhe i ka dënuar me burgim pa i pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim.*

*Mosha e personit, kushtet shëndetësore dhe mendore – ky grup rrethanash sërish nuk mund të konsiderohet si rrethanë favorizuese në rastin konkret, pasi i pandehuri është i moshës 39- vjeçare me gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe mendore, i përgjegjshëm për veprimet e kryera. Përkundrazi, mosha e tij dëshmon për një rrezikshmëri të shtuar të këtij rasti kur një person, megjithëse në një moshë të tillë, ka guximin dhe ndërmer veprime për të cilat legjislatori e ka parashikuar si vepër penale dhe parashikon një dënim me burgim nga 5 deri 10 vjet, tregon se pezullimi i ekzekutimit të dënimit nuk sjell tjetër veçse efekt të kundërt tek i pandehuri duke bërë që dënimi i tij të mos ketë asnjë lloj efekti parandalues në asnjë kuptim që mbart në vetvete ky nocion.*

*Mënyra e jetesës dhe nevojat e veçanta, veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën – këto rrethana nuk rezultojnë të pranishme në rastin konkret, pasi i pandehuri ka përfunduar arsimin që ka dashur të marrë dhe nuk ka ndjekur ndonjë proces mësimor, kurs privat etj. Në lidhje me familjen është kryefamiljar, por sasia e lëndës narkotike është e konsiderueshme dhe nuk mund të përfitojnë nga neni 59 i Kodit Penal të gjithë personat që janë kryefamiljarë.*

*Sjellja pas kryerjes së veprës penale – kjo rrethanë e cila është e lidhur ngushtë edhe me rrethanat e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë e tillë që të ndikojë në aplikimin e pezullimit të dënimit, pasi i pandehuri nuk e ka pranuar akuzën gjatë hetimit paraprak, si dhe gjatë gjykimit duke mos shprehur pendim për veprën penale. I pandehuri nuk ka bashkëpunuar që në momentin e parë me policinë duke i gënjyer ata, nuk ka pranuar akuzën dhe nuk ka bashkëpunuar me prokurorinë si gjatë hetimeve paraprake edhe gjatë gjykimit.*

*Gjykata duhej të vlerësonte fenomenin kriminal shumë shqetësues të kësaj vepre që ka tendencë në rritje në rrethin e Shkodrës – në kushtet kur aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, por jo në rastin konkret, pasi në këtë mënyrë jepet mesazhi i keq se si përdorues i lëndës narkotike që arrestohet për sasi të vogla lëndë narkotike ashtu edhe ai që arrestohet për një sasi 60 kg lëndë narkotike kanë të njëjtën rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe përjashtohen nga dënimi me burgim për pjesën e pavuajtur, pasi iu pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim duke inkurajuar kështu kontigjentin e krimit të kësaj vepre penale.*

*142.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në drejtim të verifikimeve të rezultateve të raportit të DSIK-së, rezultatet e hetimit të Komisionit në tërësinë e tyre mbështesin nxjerrjen e përfundimit nga Grupi i Punës së DSIK-së, lidhur me papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha për vijimin e detyrës.*

### **Konkluzioni për kontrollin e figurës**



1. Vepra penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 381/1 i Kodit Penal, parashikon një masë dënimi me burgim nga 5 deri në 10 vjet. Prokuroria ka kërkuar 7 vjet burgim ndërsa Gjykata (subjekti i rivlerësimit) ka dhënë dënim fillestar prej 6 vjetësh burgim. Rezulton se, si masa e dënimit fillestar të kërkuar nga Prokuroria, ashtu edhe dënimi fillestar i dhënë nga Gjykata të jenë mbi minimumin prej 5 vjetësh, masa këto që nuk të krijojnë dyshime për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit si nga Prokuroria, ashtu edhe nga gjykata, për më tepër që të dyja masat e dënimit janë të përafërta. Gjithashtu Prokuroria, në caktimin e masës së dënimit, ka sugjeruar aplikimin e kërkesave nenit 406 të K.Pr.Penale, duke ulur dënimin me 1/3 dhe dënimin e tij me 4 vjet e 8 muaj burgim. Pra, me kërkesën për dënimin përfundimtar të të pandehurit me 4.8 vjet burg, vetë Prokuroria i ka krijuar mundësinë Gjykatës që të marrë në konsideratë aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit.
2. Të gjitha shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës të kaluar nga ana e Komisionit, i gjej të plota dhe bindëse<sup>7</sup> çka kanë çuar në një

143. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.

144. Në këndvështrimin e përgjithshëm edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykses vlerëson se mospërmblidhja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit Luveda Dardha dhe shkallën e besueshmërisë së saj në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.”

<sup>7</sup> “140. Së pari vlerësoj se çështja sa më sipër është ende në gjykim dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në rastin konkret, duke u nisur nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë shoqërore, rrezikshmërisë së autorit, rrethanave rënduese dhe lehtësuese, vlerësoj se ka qenë rasti për të aplikuar dënimin alternativ, sipas nenit 59 të Kodit Penal. Ky nen parashikon se: me titull ‘Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë’ përcakton se: ‘Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata kur jep dënim me burg gjer në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. 3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata. 4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon nga e nesërmbja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendimin për pezullimin e dënimit me burgim’. Duke u nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se në mënyrë që të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, duhet të përmbushen kushtet si më poshtë:

Së pari, dhënia e një vendimi dënimi deri në 5 vjet, ku në rastin konkret ky kusht është plotësuar, pasi ndaj të pandehurit është dhënë një dënim me 6 vjet burgim, ku pas aplikimit të gjykimit të shkurtuar dënimi përfundimtar ndaj tij ka qenë 4 vjet burgim.

Së dyti, rrethanat e përcaktuara në përmbajtjen e nenit 59 të Kodit Penal nuk kërkohet domosdoshmërisht të ekzistojnë të gjitha njëkohësisht në mënyrë kumulative, por mjafton që të ekzistojë një ose disa prej tyre.

Rrezikshmëria e pakët e personit, e cila përcaktohet kryesisht nga fakti nëse ka qenë ose jo i dënuar më parë, ku në rastin konkret nuk rezultoi që i pandehuri të ishte i dënuar më parë. Fakti që e pranon ose jo akuzën nuk e bën personin më pak ose më shumë të rrezikshëm, por kjo është një rrethanë që mbahet parasysh në caktimin e masës së dënimit nga gjykata. Pasi ky është një vendim fajësie, i cili nuk ka marrë formë të prerë, në kushtet kur i pandehuri mund të pretendojë edhe pafajësi në gjykimin në apel.

Mosha apo kushtet shëndetësore, ku në rast se i pandehuri ka një moshë relativisht të madhe, por edhe relativisht të re, kjo është një rrethanë që vlerësohet në raport me rrethana të tjera, të cilat rezultojnë të provuara në gjykim, sikurse mund të jetë, ndjekja e një arsimit apo formimi profesional, mundësia e një punësimi, apo edhe kushte shëndetësore të vështira, të cilat mund të ekzistojnë si në rastin e një të pandehuri me moshë të re, por edhe me moshë të madhe.

Mënyrës së jetesës dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin, ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale. Ky rast i referohet faktit kur i pandehuri ka një mënyrë jetese të tillë që imponon

vendimmarrje të drejtë të subjektit të rivlerësimit, duke pasqyruar në mënyrë të përmbledhur argumentet se:

- i. rrethanat e përcaktuara në përmbajtjen e nenit 59 të Kodit Penal nuk kërkojnë domosdoshmërisht ekzistencën e të gjithave njëkohësisht në mënyrë kumulative, por mjafton që të ekzistojë një ose disa prej tyre. Kjo do të thotë se është në

---

*detyrime thelbësore familjare, sikurse është rasti i përkujdesjes dhe mirërritjes për fëmijë të mitur, ku në rastin konkret i pandehuri ka pasur jo një, por 5 fëmijë të mitur, nën moshën 18 vjeç, fakt i provuar në gjykim nëpërmjet certifikatës së përbërjes familjare. Nga ana tjetër rezultuan rrethana të tjera familjare, të cilat provonin pamundësinë ekonomike të familjes, në rastin konkret nënës së fëmijëve për të përballuar e vetme rritjen dhe kujdesin ndaj tyre. Pasi dhe gjendja ekonomike e të pandehurit rezultoi të paraqitej e vështirë, në kushtet kur edhe bashkëshortja e tij ishte e papunë dhe merrte familjarisht ndihmë ekonomike në masën 7.920 lekë/muaj, me nr. dosje \*\*\*. Ky fakt u provua në gjykim nëpërmjet vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2020, lëshuar nga Bashkia Vau i Dejës, sektori i ndihmës ekonomike.*

*Nevoja për punësim, duke u nisur nga rrethanat sa më sipër, përgjegjësia familjare për kujdesin dhe rritjen e 5 fëmijëve të mitur, situata e vështirë ekonomike e familjes dhe ekzistenca e një mundësie për punësim nga ana e të pandehurit, për të kontribuar, në përmirësimin dhe stabilitetin ekonomik të familjes së tij, janë rrethana të cilat gjykata ka detyrimin t'i vlerësojë në aplikimin e një prej alternativave të dënimit. Mundësia për t'u punësuar e të pandehurit, u provua në gjykim nëpërmjet subjektit V. P., me objekt aktiviteti 'bar – kafe', i cili merrte përsipër punësimin e tij. Ky fakt u provua nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. \*\*\*, datë 17.6.2020.*

*Mungesa e rrethanave cilësuese të bashkëpunimit apo më shumë se një herë, pasi rezultoi se vepra u cilësua sipas nenit 283/1 të Kodit Penal, e cila paraqet marzhe më të ulëta dënimi si në minimum ashtu edhe në maksimum.*

*Sipas standardeve ndërkombëtare, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një extrema ratio në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm 'kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës', dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë'.*

*Duke vlerësuar kohën relativisht të gjatë të qëndrimit në paraburgim të të pandehurit, prej rreth një viti, në kushtet kur qëllimi i dënimit nuk është vetëm ndëshkimi i personit, por edhe rehabilitimi i tij, vendosja e tij nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës për pjesën e pavuajtur të dënimit, për një afat maksimal 5 vjet, përmbush qëllimet e dënimit. Në çdo rast, eventualisht të mospërmbushjes së detyrimeve gjatë kohës së provës, të pandehurit, mund t'i revokohet kjo mënyrë dënimi dhe pjesa e pavuajtur mund të vuhet në burgim.*

*Sasia e lëndës narkotike, pavarësisht se në rastin konkret ka qenë relativisht e madhe, nuk është përcaktuese në përcaktimin e një personi si të rrezikshëm ose jo, por kjo është një rrethanë, e cila nuk duhet vlerësuar e ndarë nga rrethanat e tjera, të analizuar sa më sipër. Në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal është vendosur një praktikë dhe standard nga gjykata, që në rast të ekzistencës së një apo disa rrethanave të parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal, kjo alternativë duhet të gjejë zbatim, me përjashtim të veprave penale, të cilat për nga objekti që cenojnë, sikurse jeta, shëndeti, liria personale dhe vepra të tjera të kësaj natyre, kjo alternativë dënimi nuk zbatohet për shkak të rrezikshmërisë së lartë të këtyre veprave penale, duke u nisur nga objekti që synojnë të mbrojnë.*

*Theksoj se përtej arsyeve të parashtruara, ky dënim alternativ është zbatuar edhe në kushtet e pandemisë Covid-19, ku nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëpërmjet një rekomandimi të dërguar nga Ministria e Drejtësisë, drejtuar të gjitha gjykatave në Republikën e Shqipërisë, u rekomandua të zbatoheshin për aq sa ishte e mundur masat shtrënguese, të ndryshme nga ajo e 'arrestit në burg', si dhe aplikimin më të shpeshtë të dënimeve alternative, me qëllim për të parandaluar rritjen e numrit të personave që vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit, si dhe për mbrojtjen e jetesës dhe shëndetit të tyre. Kjo letër gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Për të gjitha argumentet e parashtruara sa më sipër, vlerësoj se është respektuar ligji penal material, veçanërisht të gjitha kriteret, të parashikuara në përmbajtjen e nenit 59 të Kodit Penal.*

*Gjithashtu, gjykata, në caktimin e dënimit, është e detyruar të bazohet edhe në parimet e nenit 1/c të Kodit Penal, me titull 'Parimet e Kodit Penal', ku parashikohet se: 'Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës së barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve dhe të humanizmit'.*

*Në mungesë të këtyre rrethanave, të analizuar sa më sipër, alternativa e dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal, nuk do të ishte zbatuar nga gjykata".*

- kompetencën dhe në bindjen e gjyqtarit që të vlerësojë dhe të arrijë në përfundimin nëse ekzistojnë kushtet për aplikimin e nenit 59 të K.Penal ose jo;
- ii. i pandehuri ka kryer 10 muaj burgim deri në dhënien e vendimit nga ana e Gjykatës;
  - iii. i pandehuri, në fillim të procesit gjyqësor ka kërkuar mëshirë, sikurse është pasqyruar në përmbajtjen e vendimit, çka do të thotë se ai ka pranuar faktin se ka kryer një veprim në kundërshtim me ligjin dhe ka shfaqur pendim të thellë në formën e kërimit të mëshirës përpara Gjykatës;
  - iv. i pandehuri nuk rezulton të jetë përsëritës në kryerjen e të njëjtës vepre penale, madje ai nuk rezulton të jetë i dënuar më parë ç'ka e bën atë minimalisht të rrezikshëm për shoqërinë;
  - v. i pandehuri rezulton të ketë 5 fëmijë, nga të cilët 4 janë të mitur, çka do të thotë se i pandehuri ka një mënyrë jetese të tillë që imponon detyrime thelbësore familjare, sikurse është rasti i përkujdesjes dhe mirërritjes për fëmijë të mitur dhe kjo situatë, në vetvete përbën një faktor përcaktues për aplikimin e nenit 59 të K.Penal;
  - vi. gjendja ekonomike shumë e vështirë e familjes së të pandehurit, në kushtet kur edhe bashkëshortja e tij ishte e papunë dhe merrte familjarisht ndihmë ekonomike në masën 7.920 lekë/muaj.
3. Në lidhje me konstatimet e grupit të punës së DSIK-së për papërshtatshmëri të subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës për shkak të përfshirjes në veprimtari korruptive, bazuar në informacionet e institucioneve të tjera ligjzbatuese, si dhe konkluzionet e shumicës së trupit gjykues, në respektim edhe të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GjEDNj-së në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*, me përjashtim të disa elementeve indikative, por herë - herë edhe me përmbajtje kontradiktore, nuk rezultuan prova të drejtpërdrejta, të pakontestueshme dhe shteruese që implikonin subjektin e rivlerësimit apo personin e lidhur me të në veprimtari korruptive.
- Në këndvështrimin e një rrjedhe logjike midis vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit dhe konstatimit të grupit të punës në DSIK për papërshtatshmëri, fakti i gjetjes së kësaj vendimmarrjeje në përputhje me ligjin, zbeh në mënyrë të konsiderueshme deri në pamundësi mundësinë e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit apo të personit të lidhur me të në veprime korruptive. Për rrjedhojë, kundërshtoj konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, e cila e ka gjetur të drejtë konstatimin e grupit të punës së DSIK-së për papërshtatshmëri të subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e figurës.
4. Duke e konsideruar përmbushje të rregullt të detyrës vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, arrij në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me cenim të pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha, e për më tepër me ekzistencën e elementeve që mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI TËRËSOR**

Bazuar në argumentet dhe konkluzionet e dhëna më sipër nga unë, në cilësinë e anëtarit relator të trupit gjykues në pakicë, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Luveda Dardha:

- a) ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “a” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016; Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2012 – 2016, në shumën -1,022,161 lekë, të cilën, në bazë të parimit të proporcionalitetit e vlerësoj si vlerë minimale, duke mos prodhuar pasoja të tilla, që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
- c) konsiderohet se ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016

### **PËR KËTO ARSYE,**

Unë, si anëtar në pakicë, arrij në konkluzionin se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit znj. Luveda Dardha, bazuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk është i drejtë, për rrjedhojë krijoj bindjen e bazuar në argumente, prova dhe në ligj, se shumica e trupit gjykues nuk duhet të kishte disponuar me shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha, por me konfirmimin e saj në detyrë.

**Olsi Komici**  
**Anëtar në pakicë/kundër**